



REPUBLIKA E SHQIPËRISE
MINISTRIA E INTEGRIMIT EUROPIAN

**RAPORT I MONITORIMIT TË PERFORMANCËS FINANCIARE PËR PERIUDHËN
JANAR-SHTATOR 2016**


Në zbatim të udhëzimit të Ministrit të Financave nr.2, dt.06.02.2012 "Për procedurat standarte të zbatimit të buxhetit " si dhe të udhëzimit plotësues nr.1 dt.15.01.2016 "Për zbatimin e buxhetit të vitit 2016" Ministria e Integrimit European për periudhën Janar- Shtator 2016, ka administruar dhe menaxhuar fondet të vëna në dispozicion nga Buxheti i Shtetit të vitit 2016, ndryshuar me Aktin Normativ nr.1 dt.29.07.2016, përkatësisht sipas tre programeve të miratuara, si më poshtë:

- **Planifikimi, Menaxhimi, Administrimi**
- **Drejtësia dhe Tregu i Brendshëm**
- **Mbështetja Institucionale për Procesin e Integrimit**

Gjatë 9-mujorit të vitit 2016 përdorimi i fondeve buxhetore është bazuar në respektimin korrekt të planit të buxhetit të vitit 2016 të miratuar, sipas tre programeve, artikujve, kapitujve në lidhje me pagat, sigurimet shoqërore dhe shëndetsore, shpenzimet operative, investimeve të brendshme dhe financimeve të huaja duke siguruar një menaxhim dhe përdorim të fondeve buxhetore me transparencë, eficiencë dhe efektivitet të plotë. Buxheti i planifikuar i ndryshuar me Aktin Normativ nr.1 dt.29.07.2016 bashkë me financimet e huaja për gjithë Ministrinë e Integrimit Evropian gjatë periudhës 9-mujore, është realizuar në masën 59 % sikurse duket edhe nga tabela dhe grafiku i mëposhtëm.

000/leke

Emertimi i zerave te Buxhetit	Buxheti 2016	Buxheti i Rishikuar AKT NORMATIV	Fakti 9 Mujor 2016	Realizimi ne %
Paga	103,600.0	99,100.0	66,662.0	67
Sigurime Shoqërore	16,400.0	16,400.0	10,525.0	64
Mallra dhe Shërbime të Tjera	49,640.0	64,140.0	26,593.0	42
Trans per Buxh. Fam. & Individ	360.0	443.0	353.0	80
Kapitale te brendshme	50,000.0	50,000.0	17,989.0	36
Financime te huaja total	220,000	105,000	75,234.0	72
TOTALI	440,000.0	335,083.0	197,356.0	59



***Tabela e realizimit 9-mujor 2016 te planit te buxhetit pas ndryshimeve me AN sipas tre programeve:**

Nr	Emri i programit	Plani i fondeve sipas PBA 2016-2018 mln(leke)	Buxheti 2016 pas AN	Struktura e Buxhetit ne %	Ne mln/leke		
					Fakti		
					9-mujor viti 2016		
					Në mln leke	Realizimi ne % ndaj buxh	Struktura ne %
1	Planifikimi, Menaxhimi, Administrimi	53.4	67	20	41	60	21
2	Drejtësia dhe Tregu i Brendshëm	29.4	31	9	20	66	10
3	Mbështetja Institucionale për Procesin e Integrimit	334.2	237	71	136	58	69
	Totali	417	335	100	197	59	100

****Struktura e shpenzimeve të Ministrisë së Integrimit, për çdo program, sipas PBA-së 2016-2018, buxhetit të miratuar 2016 , pas ndryshimit me Aktin Normativ dhe realizimit faktik për 9-mujorin e vitit 2016, jepet në % sipas tabelës:**


Nr	Emri i programit	Struktura e fondeve te planifikuara sipas PBA-së 2016-2018 (ne %)	Struktura e Buxhetit Viti 2016 (ne %)	Struktura e shpenzimeve faktike për 9-mujor 2016 (ne %)
1	Planifikimi, Menaxhimi, Administrimi	12	20	21
2	Drejtësia dhe Tregu i Brendshëm	7	9	10
3	Mbështetja Institucionale për Procesin e Integrimit	81	71	69
	Totali	100	100	100

Në vijim paraqiten më të detajuar realizimet e buxhetit 9-mujor 2016 sipas programeve perkatese dhe problematikat gjatë zbatimit të tij :

- **01110 Programi “Planifikimi, Menaxhimi, Administrimi”**

Për kryerjen e veprimtarisë kryesore dhe përmbushjen e objektivave të përcaktuara në këtë program kemi një realizim të shpenzimeve në raport me buxhetin e planifikuar pas ndryshimit me AN , rreth 60 % . Krahasuar me planin vjetor të ndryshuar me Aktin Normativ zërat kryesor , rezultojnë si me poshtë:

Emertimi shpenzimeve	Buxheti v.2016 në 000 lekë pas ndryshimit me AN	Realizimi v. 2016	
		9-muj Në 000 lekë	Ne %
Shpenzime Korrente	66,483	40,280	61
Shpenzime kapitale te brendshme	1,000	503	50
TOTALI	67,483	40,783	60



Për këtë program për 9-mujorin e vitit 2016 dhe në vazhdim janë parashikuar për tu realizuar 10 produkte sipas tabelës së mëposhtëme,

Produkti	Buxheti v.2016 në 000 lekë	(Në 000/lekë)		
		Realizimi 9-muj Në 000 lekë	Ne %	Statusi i v. 2016 produktit
1. Menaxhim i burimeve njerëzore	28,483	18,000	63	Pjesërisht
2.Pajisje zyresh të tjera	107	107	100	Plotësisht
3.Pajisje elektrike, elektronike të reja	396	396	100	Plotësisht
4.Shërbim auditim i brendshëm	3,300	2,500	76	Pjesërisht
5. Sigurim i shërbimeve të përgjithshme, mjedisit dhe infrastrukturës fizike për stafin	5,840	3,400	58	Pjesërisht
6. Shërbime financiare	12,770	7,200	56	Pjesërisht
7. Menaxhim i larte	13,690	7,830	57	Pjesërisht
8. Marredhenie nderkombetare	1,700	900	52	Pjesërisht
9. Shërbime ligjore	700	450	64	Pjesërisht
10.Ndertim i rampes	497	0	0	Aspak
TOTALI	67,483	40,783	60	


Sa sipër vërehet se për programin 110 “Planifikim, Menaxhim, Administrim “ kemi një realizim normal të shpenzimeve korrente dhe investime të cilat janë të realizueshme deri në fund të vitit 2016.

- **Programi “Drejtësia dhe Tregu i Brendshëm”**

Me Aktin Normativ të Këshillit të Ministrave Nr. 1, datë 29.7.2016 “Për disa ndryshime në Ligjin Nr. 147/2015, “Për buxhetin e vitit 2016”, pati një shtesë fondesh në programin Drejtësia dhe Tregu i Brendshëm. Kështu buxheti total për këtë program u rrit nga 29.400.000 Lekë në 30.900.000 Lekë. Shtesa është bërë në zërin 602 “Mallra dhe shërbime të tjera” me një rritje prej 1.500.000 Lekë.

Gjatë nëntëmuorit të parë të vitit 2016, për programin Drejtësia dhe Tregu i Brendshëm, sikurse tregohet edhe në tabelën e mëposhtme, i cili ka në plan vetëm shpenzime korrente, janë përdorur 20.441.000 Lekë, ose afërsisht 66% e buxhetit të alokuar për vitin 2016.

Emertimi shpenzimeve	Buxheti v.2016 ne 000/leke	Fakti 9-mujor v. 2016 ne 000/leke
Shpenzime totale	30,900	20,441



Në këtë program buxhetor, gjatë të vitit 2016, nuk ka pasur asnjë ndryshim për sa i përket numrit të produkteve apo njësive matëse të çdo produkti. Kostot e produkteve apo për njësi përgjithësisht janë respektuar dhe nuk ka tejkalime të kostove.

Programi buxhetor Drejtësia dhe Tregu i Brendshëm ka katër produkte. Një nga këto produkte është realizuar plotësisht. Dy produkte të tjera janë në realizim e sipër. Një nga produktet nuk ka filluar të realizohet.

Realizimi për secilin nga katër produktet e këtij programi paraqitet si më poshtë:

(në 000 lekë)

Nr.	Emri i produktit	Buxheti 2016 (i rishikuar)	Realizimi 9-mujori I, 2016		
			Fakti Q1+Q2+Q3	% ndaj buxhetit	Statusi i produktit
1	Takime të institucioneve të përbashkëta Shqipëri – Bashkimi Evropian	13.200.0	8.541.0	65	Pjesërisht
2	Kontributi i Qeverisë shqiptare për Raportin e Progresit	8.000.0	7.000.0	88	Plotësisht
3	Plani Kombëtar për Integrimin Evropian	7.400	4.900.0	66	Pjesërisht
4	Kapituj negociues të mbyllur provizorisht në kuadër të anëtarësimit të Shqipërisë në BE	2.300.0	0.0	0.0	Aspak
	TOTALI	30.900.0	20.441.0	66	

Produkti 1, Takime të institucioneve të përbashkëta Shqipëri – Bashkimi Evropian, është realizuar pjesërisht gjatë nëntëmujorit të parë të vitit 2016.

Gjatë tremujorit të tretë nuk u zhvillua asnjë takim i institucioneve të përbashkëta Shqipëri – Bashkimi Evropian. Gjatë këtij tremujori vijoi puna për hartimin e minutave të takimeve të zhvilluara gjatë tremujorit të dytë, për analizën e rekomandimeve dhe dërgimin e informacioneve plotësuese.

Në këtë kuadër, u hartuan minutat e:

- Takimit të Komitetit të Stabilizim-Asociimit, zhvilluar në Tiranë, me datë 9 qershor 2016;
- Takimit të Nënkomitetit Tregu i Brendshëm dhe Konkurrenca, duke përfshirë Mbrojtjen e Konsumatorit dhe Shëndetit, zhvilluar në Tiranë, me datë 26 maj 2016.

Në vijim të takimit të Nënkomitetit Transporti, Energjia, Mjedisi dhe Zhvillimi Rajonal, zhvilluar në Bruksel, me datë 21 prill 2016, Ministria e Integritimit Europian koordinoi hartimin dhe dërgimin e një raportimi vijues mbi plotësimin e rekomandimeve të palës evropiane. Raportimi iu dërgua shërbimeve të Komisionit Evropian me datë 15 korrik 2016.

Produkti 2, Kontributi i Qeverisë shqiptare për Raportin e Progresit 2016, është realizuar plotësisht gjatë nëntëmujorit të parë të vitit 2016. Kontributi i parë i Qeverisë shqiptare për Raportin e Komisionit Evropian për Shqipërinë për vitin 2016 iu paraqit shërbimeve të Komisionit Evropian me datë 23 maj 2016. Kontributi i dytë i Qeverisë shqiptare iu paraqit shërbimeve të Komisionit Evropian me datë 1 shtator 2016.

Produkti 3, Plani Kombëtar për Integrimin Evropian, u realizua pjesërisht gjatë nëntëmujorit të parë të vitit 2016. Gjatë tremujorit të tretë u krye analiza e dytë e realizimit të Planit Kombëtar për Integrimin Evropian 2016 – 2020, për gjashtëmujorin e parë të vitit 2016. Më pas, Ministria e Integritimit Europian ka ndjekur në vijimësi problematikat e zbatimit të Planit duke përcaktuar edhe detyra konkrete për realizimin e tij. Monitorimi i PKIE 2016 – 2020 do të vazhdojë edhe gjatë tremujorit të fundit të vitit 2016.

Produkti 4, Kapituj negociues të mbyllur provizorisht në kuadër të anëtarësimit të Shqipërisë në BE, nuk është realizuar. Produkti do të fillojë të realizohet pas marrjes së vendimit për hapjen e negociatave nga ana e Këshillit Evropian.


01150 Programi “Mbështetja institucionale për Procesin e Integrimit”

Për këtë Program në buxhetin e vitit 2016 janë alokuar 346.200,000 lekë. Në buxhetin e parashikuar për vitin 2016, është e përfshirë edhe asistenca e huaj në dobi të Ministrisë së Integrimit European, përkatësisht në shumën prej 220.000.000 Lekë për këtë program. Nëpërmjet rishikimit me Akt Normativ, vlera e investimeve me Financim të Huaj në favor të MIE është ulur në shumën 105.000.000 ALL.

Për nëntë-mujorin e parë të vitit 2016, nga ky program, nga financimi i brendshëm janë realizuar **131,700,000 leke ne 60,898,000 leke ose 45 %**. Buxheti total bashkë me financimet e huaja është realizuar nga 236,700,000 në 136,132,000 lekë ose afërsisht 58 %.

Ndërsa shuma e realizuar e financimit të huaj është **75.234.000 lekë**, ose rreth **72%** e tij. Bashkëlidhur gjeni raportet e financimeve të huaja për nëntëmujorin e parë të vitit 2016.

Emertimi shpenzimeve	Buxheti v.2016 ne 000/leke	Fakti 9-mujor v. 2016 ne 000/leke
Shpenzime Korrente	82,700	43,411
Shpenzime kapitale te brendshme	49,000	17,487
Totali financime te brendshme	131,700	60,898
Financimet e huaja	105,000	75,234
TOTALI	236,700	136,132



(në mijëra Lekë)

Realizimi i 9-mujorit të vitit 2016					
Emri i Produktit		Buxheti 2016	Fakti 2016	Në %	Statusi i produktit
A	Akteve ligjore evropiane te perkthyer ne shqip dhe anasjelltas, dhe dokumentave te tjera te rendesishme ne proc. e stabilizimit	28,000.00	6,050.00	21.6%	Pjeserisht
B	Mendime ligjore te hartuara per peraftrimin e legjislacionit Evropian	5,430.00	2,050.00	37.8%	Pjeserisht
C	PKIE e hartuar	5,650.00	4,000.00	70.8%	Plotesisht
D	Progres Raporti i hartuar	4,200.00	3,900.00	92.9%	Plotesisht
E	Informimi mbi procesin e anetaresimit ne BE	28,520.00	12,907.00	45.3%	Pjeserisht
F	500 GRA te informuara dhe trajnuara	5,700.00	3,150.00	55.3%	Pjeserisht
G	Sisteme dhe infrastrukture e teknologjise se informacionit te mirembajtura	5,850.00	2,950.00	50.4%	Pjeserisht
H	Programimi i asistences financiare te BE sipas prioriteteve	34,500.00	18,900.00	54.8%	Pjeserisht
I	Programimi i paketes WBIF dhe IPA shumeperfitues	4,200.00	1,537.00	36.6%	Pjeserisht
K	Monitorimi i zbatimit te programeve IPA	7,000.00	3,950.00	56.4%	Pjeserisht
L	Informimi i shoq.civile lidhur me nismat ligjore te ndermara	2,650.00	1,504.0	56.8%	Pjeserisht
M	Koordinimi i pjesmarries se Shqiperise ne programet e Bashkepunitit Nderkufitar dhe Transnacional	53,000.00	45,000.00	84.9%	Pjeserisht
N	Menaxhimi i implementimit te projekteve	52,000.00	30,234.00	58.1%	Pjeserisht
	SHUMA	236,700.0	136,132.0	57.51%	
	Asistenca teknike IPA-Adriatic 2007-2013	29,147.0	17,288.0	59.3%	Pjeserisht
	Asistenca teknike IPA-CBC Shqiperi -Mal i Zi	7,140.0	7,140.0	100.0%	Plotesisht
	Asistenca teknike IPA-CBC Greqi-Shqiperi	13,578.0	6,414.0	47.2%	Pjeserisht
	Asistenca tekniike IPA-CBC Shqiperi-Maqedoni	5,000.0	5,000.0	100.0%	Plotesisht
	Asistenca tekniike IPA-CBC Shqiperi-Kosove	5,040.0	2,772.0	55.0%	Pjeserisht
	Asistence teknike MED (Mesdheu)	1,500.0	0.0	0.0%	Aspak

	Asistenca teknike IPA CBC Itali-Shqiperi-Mali i Zi	3,775.0	0.0	0.0%	Aspak
	Asistenca Teknike IPA, ADRION	2,000.0	0.0	0.0%	Aspak
	Asistenca Teknike, Projekti Strategjik ADRION	0.0	0.0		N/A
	SMEI	15,000.0	15,000.0	100.0%	Plotesisht
	PPF	21,620.0	21,620.0	100.0%	Plotesisht
	Tot Financimi i Huaj	105,000.00	75,234.00	71.65%	

Gjatë këtij nëntëmujori janë realizuar pjesërisht 12 produkte dhe 1 produkt plotësisht. Përsa i përket financimeve të brendshme, ndërsa për Financimet e Huaja janë realizuar 4 Produkte plotësisht, 3 pjesërisht dhe 4 Aspak.

Gjatë nëntëmujorit të vitit 2016, për sa i përket produkteve të parashikuara për këtë program, statusi i realizimit të aktiviteteve është si më poshtë:

A. Mendime ligjore të hartuara për përafrimin e legjislacionit evropian

Gjatë nëntë-mujorit të vitit 2016, janë dhënë 70 mendime ligjore për përafrimin e legjislacionit evropian nga projektaktet ligjore të paraqitura për miratim në Këshillin e Ministrave dhe Kuvendin e Shqipërisë si dhe aktet ligjore të nxjerra nga ministrat. Në total, numri i mendimeve ligjore për tremujorin e tretë është 150 mendime ligjore mbi përafrimin e legjislacionit shqiptar me *acquis* e Bashkimit Evropian.

B. Akte ligjore evropiane të përkthyer në shqip dhe anasjelltas, dhe dokumenteve të tjera të rëndësishme në procesin e stabilizimit-asociimit

Gjatë periudhës së raportimit, ka vazhduar përkthimi i akteve ligjore dhe i dokumenteve të tjera të rëndësishme në procesin e anëtarësimit në Bashkimin Evropian. Ndërkohë, janë përkthyer dhe rishikuar 2500 akte të legjislacionit të Bashkimit Evropian në gjuhën shqipe dhe anasjelltas **dhe dokumenteve të tjera të rëndësishme në procesin e stabilizimit-asociimit** për tremujorin e tretë

C. PKIE e hartuar

Ky produkt u realizua plotësisht gjatë tremujorit të parë. Plani Kombëtar për Integrimin Evropian 2016 – 2020 u hartua dhe u miratua gjatë tremujorit të parë të vitit 2016. PKIE 2016 – 2020 u miratua me Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr. 74, datë 27.01.2016.

D. Raporti i KE-së i hartuar

Gjatë tremujorit të tretë 2016, u përfundua dhe u dërgua pranë shërbimeve të Komisionit Evropian më 1 shtator 2016, kontributi i dytë i Raportit të KE-së.

E. Informimi mbi procesin e anëtarësimit në Bashkimin Evropian

Gjatë tremujorit të tretë të vitit 2016 janë informuar rreth 400 persona, kryesisht studentë, gazetarë, përfaqësues nga komunitete të ndryshme në lidhje me procesin e anëtarësimit në Bashkimin Evropian. Një pjesë e

konsiderueshme e tyre u informuan gjatë aktiviteteve të zhvilluara në bashkëpunim me Delegacionin e Bashkimit Evropian dhe EU-info Center, si më poshtë vijon:

- Trajnimi “Komunikim për Europën dhe Çështjet e Integritetit Evropian”, me gazetarë nga Tirana, Shkoder dhe Vlora.
- Aktiviteti ndërkombëtar “Integrimi i Komunitetit Rom dhe Forcimi i Bashkëpunimit midis Vendeve në Rajon”.
- Tryezë bashkëbisedimi e kryesuar nga Zëvendësministrija e Integritetit dhe e ministrisë së Punëve të Jashtme me një panel gazetarësh nga një sërë agjencishë prestigjioze lajmesh evropiane.

F. 500 gra të informuara dhe të trajnuara

Ministria e Integritetit Evropian gjatë tremujorit të tretë ka kontribuar në informimin dhe ndërgjegjësimin e rreth 300 grave dhe vajzave. Kjo është realizuar kryesisht përmes pjesëmarrjes në takime informuese të drejtuar nga zv.ministria e Integritetit me përfaqësues të shoqërisë civile fillimisht në Lezhë e më pas në Korçë, Shkodër, Pukë, Tiranë, Elbasan, Pogradec, Vlorë, Gjirokastrë, Sarandë, Fier. Takimet, të organizuara në bashkëpunim me bashkitë respektive të këtyre qyteteve.

G. Sisteme dhe infrastruktura e teknologjisë së informacionit dhe komunikimit (TIK) të mirëmbajtura

Gjatë tremujorit të tretë 2016, ka vazhduar puna për mirëmbajtjen e infrastrukturës dhe sistemeve të teknologjisë së informacionit dhe komunikimit në kuadër të procesit të anëtarësimit të Shqipërisë në Bashkimin Evropian. Është punuar për përmirësimin dhe aktivizimin e Sistemit të Planit Kombëtar për Integritetin Evropian dhe Ndarjes së Acquis si dhe është mirëmbajtur / administruar infrastruktura e përgjithshme TIK të MIE si pjesë e rrjetit qeveritar Govnet (konfiguruar dhe administruar platforma Active Directory, email-i zyrtar, rrjeti kompjuterik (LAN) etj).

Gjithashtu ka vazhduar puna për mirëmbajtjen dhe pasurimin e faqes zyrtare të internetit të Ministrisë së Integritetit Evropian. Në faqen zyrtare të internetit të ministrisë janë pasqyruar takimet e Ministres, takimet apo aktivitetet kryesore të organizuara, njoftime, dokumente strategjike, publikime, etj.

H. Programimi i asistencës financiare të BE sipas prioriteteve

Kanë vijuar takimet për të përmirësuar kontaktat e reformës sektoriale për fushat e Anti korrupsionit dhe Transportit, në kuadër të programimit IPA 2016. Ndërkohë po punohet me ekspertizë të vecantë për të përmirësuar SPD-të e programit IPA 2017. Më konkretisht:

Për sa i përket **programimit IPA 2016**, gjatë muajit shtator 2016, janë ri dërguar të finalizuara Dokumentet e Veprimt (AD) për diskutim në takimin e ‘Fast Committee’ gjatë muajit nëntor 2016. Vendimi i Komisionit Evropian për këtë paketë pritet të merret gjatë muajit dhjetor 2016.

Për sa i përket **programimit IPA 2017**, vijon procesi i rishikimit të Dokumenteve të Planifikimit Sektorial (SPD) për Sektorin e Drejtësisë dhe Ujit, e ndërkohë vijon procesi i përgatitjes së SPD për Sektorin e Konkurrencës e Inovacionit me fokus të veçantë mbi trashëgiminë kulturore dhe turizmin. Sipas kalendarit të Komisionit, drafti i parë i SPD-vë të lartpërmendura duhet të dërgohet për komente pranë EC brenda muajit nëntor 2016.

Shumat indikative të përfitimit për secilin sektor ende nuk janë përcaktuar.

I. Programimi i paketës WBIF dhe IPA shumëpërfitues

Përsa i përket Programit **IPA me Shumë-Vende përfituese për vitin 2016**, më datën 20 korrik 2016, Komisioni European ka miratuar Vendimin Zbatues për të gjitha vendet e Ballkanit Perëndimor dhe Turqinë.

Gjithashtu, KE ka miratuar me Vendimi Zbatues “Instrumentin lehtësues për shoqërinë civile dhe programin e medias për vitet 2016-2017”.

IPA me Shumë Vende përfituese (IPA MC) për vitin 2017: Ne vijim te caktimit te prioriteteve për IPA MC 2017, Komisionit European ka hartuar draftet e Dokumenteve të Veprimit për vitin 2017. Aktualisht, MIE po konsulton paketën e IPA MC 2017 me institucionet përfituese.

Instrumenti i Investimeve për Ballkanin Perëndimor (WBIF): Në datën 31 mars 2016, në thirrjen e parë për grante bashkëfinancimi, Shqipëria ka aplikuar për projektpropozimin “Rehabilitimi i hekurudhës Durrës – Terminali transportit publik Tiranë dhe ndërtimin e hekurudhës të re me aeroportin e Rinasit”. Në Komitetit Drejtues të WBIF, të datës 16 – 17 qershor 2016, ka pasur reagime pozitive nga KE dhe WBIF për këtë projektpropozim. Vendimi nëse ky propozim do të mbështeten nga WBIF do të merret në takimet e Komitetit Drejtues, brenda vitit 2016.

Në datat 16 – 17 qershor 2016, Komiteti Drejtues shpalli zyrtarisht edhe projektet fituese për asistencë teknike të Raundit të 15-të të WBIF:

- Studimi për rehabilitimin e linjës hekurudhore Vora – Hani i Hotit;
- Studimi i para-fisibilitetit dhe ndikimit në mjedis për projektin e tubacionit të gazit nga Shqipëria në Kosovë.
- Hartimi i dizajnit fillestare dhe asaj kryesore të projektit të Gazit Adriatik Jonian” me përfitues Shqipërinë dhe Malin e Zi.

Në kuadër të thirrjes së 16^{të} për projekte për Asistencë Teknike, Shqipëria ka aplikuar për 4 projekt propozime, përkatësisht 2 në fushën e transportit hekurudhor, 1 në fushën sociale si dhe një në fushën e energjisë/gazit.

K. Monitorimi i zbatimit të programeve IPA

Monitorimi i projekteve IPA në zbatim ka vijuar gjatë periudhës së raportimit. Zyra mbështetëse e Koordinatorit Kombëtar të IPA-s (KKIPA) ka monitoruar dhe ndërmjetësuar zgjidhjen e çështjeve problematike të projekteve të raportuara nga Delegacioni i Bashkimit Evropian me përfituesit shqiptarë nëpërmjet takimeve më të shpeshta të organizuara me institucionet përfituese dhe DBE-në, ndjekjes së afërt të problemeve, komunikimit dhe raportimit si dhe kryerjes së vizitave monitoruese në vendin e projektit. Si rezultat, disa projekte janë eliminuar nga lista e projekteve problematike, megjithëse mbeten ende çështje të pazgjidhura të cilat vazhdojnë të ndiqen nga zyra mbështetëse e KKIPA.

Gjithashtu, MIE në rolin e KKIPA ka filluar monitorimin e projekteve në zbatim të decentralizuar nga programet IPA 2012, 2013 dhe 2014.

Po punohet për ngritjen e Komiteteve Sektoriale të Monitorimit të IPA II si dhe organizimin e Komitetit (vjetor) të Monitorimit të IPAs Shqipëri-BE.

Për sa i takon akreditimit të sistemit shqiptar të menaxhimit indirekt të fondeve IPA, zyra mbështetëse e KKIPA po përgatitet për të pritur misionin e auditimit nga Komisioni European lidhur me verifikimin e plotësimit të kushteve të menaxhimit indirekt të programit IPA 2014 dhe rekomandimeve të tjera vecanërisht lidhur me sistemin e teknologjisë së informacionit.

L. Informimi i shoqërisë civile lidhur me nismat ligjore të ndërmarra

Në kuadër të zbatimit të Dokumentit të Veprimit, EU Integration Facility 2014, Ministria e Integritetit ka finalizuar Guidën e Aplikantit për aktivitetin e parashikuar në këtë Dokument “Mbështetje Për Organizatat e Shoqërisë Civile për rritjen e Dialogut Politik dhe Ndërgjegjësimin për Procesin e Integritetit European”. Për

këtë qëllim, janë zhvilluar takime informuese me organizatat e shoqërisë civile në Shkodër, Vlorë, Gjirokastrë, Pogradec, Tiranë.

M. Koordinimi i pjesëmarrjes së Shqipërisë në Programet e Bashkëpunimit Ndërkufitar dhe Transnacional

Gjatë periudhës raportuese, MIE ka vijuar me koordinimin e punës për përmbushjen e të gjithë objektivave që rrjedhin nga pjesëmarrja e Shqipërisë në Programet BNK dhe Transnacionale. Konkretisht programet në të cilat merr pjesë Shqipëria dhe që janë miratuar nga Komisioni Evropian janë: Shqipëri – Kosovë, Maqedoni – Shqipëri, Mali i Zi – Shqipëri, Greqi – Shqipëri, ADRIAN, MED, Balkan – Mediterranean dhe Programi Trilateral Itali – Shqipëri – Mali i Zi.

Në këtë periudhë janë organizuar edhe sesione informuese për aktorët e interesuar në kuadër të shpalljes së thirrjeve për projekt propozime të programeve Adrian, Balkan – Mediterranean, Greqi – Shqipëri, Mali i Zi-Shqipëri, Maqedoni-Shqipëri.

Deri më tani, janë miratuar tre Marrëveshje Financimi (Programet Mali i Zi – Shqipëri, Shqipëri – Kosovë, Maqedoni – Shqipëri), janë në proces miratimi Programi Trilateral IPA BNK Itali – Shqipëri – Mali i Zi dhe programi Greqi – Shqipëri, ndërkohë jemi në pritje të nënshkrimit nga KE të programeve të tjera transnacionale: Balkan – Mediterranean, MED dhe Adrian.

N. Menaxhimi i Implementimit të Projekteve

MIE vijon me ndjekjen e zbatimit të kontratave të grantit / implementimin e projekteve. Gjithashtu, MIE përfiton nga projektet e asistencës teknike të nevojshëm për përmirësimi e kapaciteteve të Strukturave të Përbashkëta për zbatimin e programeve dhe monitoron realizimin e tyre. Në nëntë mujorin e parë është monitoruar ecuria e projekteve të Asistencës Teknike për 5 programe (IPA Adriatic, Shqipëri-Kosovë, Mali i Zi-Shqipëri, Maqedoni-Shqipëri dhe Greqi-Shqipëri).

Objekti kryesor i këtij produkti është rritja e efikasitetit dhe aftësisë për përthithjen e fondeve të BE-së në Shqipëri, nëpërmjet përmirësimit të procesit të monitorimit të zbatimit të Programeve/projekteve të BNK dhe Transnacionale.

Për sa i përket nëntë mujorit 2016, MIE ka vazhduar me monitorimin e projekteve në zbatim dhe ka ndërmjetësuar në zgjidhjen e rasteve problematike. Për këtë qëllim janë zhvilluar vizita monitoruese dhe takime me përfituesit e projekteve.

Me qëllim rritjen e kapaciteteve të përfituesve (Autoritetet lokale dhe Organizatat) janë zhvilluar trajnime dhe evente informuese në kuadër të Programeve me Malin e Zi, Greqinë, Kosovën dhe Maqedoninë.

Duke qenë se Programet e periudhës 2007 – 2013 janë në përfundim, janë zhvilluar evente vizibiliteti për përmblylljen e tyre dhe promovimin e rezultateve të Programeve / projekteve të zbatuar.

